



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

Në mbështetje të Nenit 108/A të ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 068 dhe ligjin 05/L-092, duke u bazuar në ankesën e bërë nga OE „Eing-Com“shpk, Dumosh – Podujevë pjesëmarrës në tenderin „Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan“ me nr. të prok. 613-20-2177-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 613 020 041 521, Autoriteti Kontraktues Komuna Lipjanit, rrespektivisht zyrtari përgjegjës i prokurimit, nxjerrë këtë:

VENDIM

Refuzohet kërkesa (ankesa) e propozuar për shqyrtim si e pabazë e OE „Eing-Com“shpk, Dumosh – Podujevë, pjesëmarrës në tenderin „Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan“ me nr. të prok. 613-20-2177-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 613 020 041 521

RAPORTI ZYRTAR PËRGJEGJËS I PROKURIMIT

	24.06.2020	26.06.2020	29.06.2020
Nëshkrimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	Data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim	Data e fillimit të shqyrtimit të kërkesës	Data e dorzimit të raportit tek OE „Eing-Com“shpk, Dumosh – Podujevë

Neni 108/A zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve

Me date 24.06.2020, AK ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të lëndës nga OE „Eing-Com“shpk, Dumosh – Podujevë, pjesëmarrës në tenderin „Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan“ me nr. të prok. 613-20-2177-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 613 020 041 521, inicuar nga AK Komuna e Lipjanit, rrespektivisht Drejtoria e Prokurimit në Lipjan.

Konform Nenit 108/A pika 6 e LPP-së dhe konform kërkesës së datës 24.06.2020, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën me titull: „Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan“ me nr. të prok. 613-20-2177-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 613 020 041 521

Procesi i Prokurimit:

Data e njoftimit për Kontratë.....	22.05.2020
Lloji i Procedurës së aplikuar.....	hapur
Lloji dhe vlera e Kontratës së aplikuar.....	punë/mesme
Afati i fundit i dorzimit të ofertave.....	12.06.2020
Data e hapjes së ofertave	12.06.2020
Njoftim mbi vendimin e AK.....	23.06.2020

Rexhistri i ofertuesve

Nr	Emri dhe adresa e OE	Vlera totale e ofertës në €
1	„Ledi Ing“ shpk	227,623.50
2	Grupi i OE „Parajsa“ shpk&NNSH „Emsa“	218,537.70
3	„EL-BAU“ shpk	228,101.53
4	Grupi i OE „Eing-Com“ shpk&NPT „Daqa“	246,771.36
5	„LONI“ shpk	249,765.67
6	„U-UNIQUE“ shpk.	249,775.87

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve, si OE i suksesshëm mbetet:

Grupi i OE „Parajsa“ shpk&NNSH „Emsa“	218,537.70
---------------------------------------	------------

Komisioni për vlerësimin e ofertve rekomandon për Kontratë Grupi i OE „Parajsa“ shpk&NNSH „Emsa“

Analizat dhe saqarimet e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, pas shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së prokurimit dhe pretendimet e pales në ankesë (kërkesë), sqaron si vijon:

Në pikat pretenduese: Shkelje e dispozitave Ligjit të Prokurimit Publik

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 65 - Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 41 - Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës

- Pretendimet OE ankues „Eing-Com“ shpk, se çmimet janë jonormalisht të ulta nuk qëndrojnë. Duke u nisur nga **Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**, asnjë prej kriterëve që tregojnë se është çmim jonormalisht i ultë, nuk plotësohet.
 - AK gjatë udhëheqjes së kësaj procedurave të prokurimit kem siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë OE ofertues.
 - Ju kemi përmbajtë të kriterëve të parapara, me theks të vacant çmimit të ofruar, afatet e dorzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive,
 - Është bërë krahasimi efektiv i kërkesave për pesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet
- Duke u nisur nga Dispozitat e LPP-së dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik mbi specifikimet teknike:

20 Specifikimet Teknike

20.4 Specifikimet Teknike do të jenë qartë, sakt dhe precise dhe duhet të mos paraqesin **kufizime të panevojshme në mënyrë që të mos kufizohet konkurenca**. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijohen dyshime rreth natyrës së mallërave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Sa i përket direktivave të BE –së, parimi theksohet si:

Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje tëbarabart për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik

Komisioni i caktuar për rivlerësim të ofertave nga Drejtoria e Prokurimit, ka përfunduar këtë rivlerësim duke u bazuar në Ligjet e LPP, se Grupi i OE „Parajsa“ shpk&NNSH „Emsa“ i propozuar për Kontratë, ka rrespektuar të gjitha kërkesat e AK duke u bazuar në LPP

1. Të gjitha pikat që pretendoni si shkelje e LPP-së, AK i renditë si të pabazuara

Ne si AK dhe komisioni i caktuar për vlerësim të ofertave pjesëmarrëse, deklarojm që ofertat janë vlerësuar me përgjegjësi të plotë duke i rrespektuar LPP

Asnjëra nga pikat e LPP-së nuk është shkelur nga ne si AK

Zyrtari përgjegës i prokurimit, bazuar në sqarimet e cekura në raport, mendon se AK për aktivitetin e prokurimit me titull „Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan“ me nr. të prok. 613-20-2177-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 613 020 041 521, ka rrespektuar në tërësi dispozitat e LPP-së në fuqi.

Gjithashtu, zyrtari përgjegës i prokurimit, ankesën e OE „Eing-Com“shpk, e konsideron si të pabazë